

DEKRET
Nr.2110, datë 29.5.1998

**PËR KRIJIMIN E RRETHEVE GJYQËSORE, ÇAKTIMIN E KOMPETENCAVE
TOKËSORE DHE TË QENDRËS SË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 11 të ligjit nr.8265, datë 18.12.1997 "Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë" me propozimin e Ministrit të Drejtësisë,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në territorin e Republikës së Shqipërisë krijohen 29 rrethe gjyqësore me kompetenca tokësore dhe qendra të ushtrimit të veprimtarisë së tyre si më poshtë:

1. Rrethi gjyqësor i Dibrës me qendër në Peshkopi, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Dibrës.
2. Rrethi gjyqësor i Sarandës me qendër në Sarandë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Sarandë e Delvinë.
3. Rrethi gjyqësor i Korçës me qendër në Korçë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Korçë e Devoll.
4. Rrethi gjyqësor i Kukësit me qendër në Kukës, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Kukës e Has.
5. Rrethi gjyqësor i Beratit me qendër në Berat, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Berat e Kuçovë.
6. Rrethi gjyqësor i Shkodrës me qendër në Shkodër, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër e Malësi e Madhe.
7. Rrethi gjyqësor i Fierit me qendër në Fier, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Fier dhe Mallakastër.
8. Rrethi gjyqësor i Elbasanit me qendër në Elbasan, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Elbasan dhe Peqin.
9. Rrethi gjyqësor i Durrësit me qendër në Durrës, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Durrësit.
10. Rrethi gjyqësor i Gramshit me qendër në Gramsh, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Gramshit.
11. Rrethi gjyqësor i Gjirokastrës me qendër në Gjirokastrë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Gjirokastrës.
12. Rrethi gjyqësor i me qendër në Kavajë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kavajës.
13. Rrethi gjyqësor i Krujës me qendër në Krujë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Krujës.
14. Rrethi gjyqësor i Kurbinit me qendër në Laç, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kurbinit.
15. Rrethi gjyqësor i Lezhës me qendër në Lezhë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Lezhës.
16. Rrethi gjyqësor i Librazhdit me qendër në Librazhd, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Librazhdit.
17. Rrethi gjyqësor i Lushnjës me qendër në Lushnjë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Lushnjës.
18. Rrethi gjyqësor i Matit me qendër në Burrel, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Matit.

19. Rrethi gjyqësor i Mirditës me qendër në Rrëshen, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Mirditës.

20. Rrethi gjyqësor i Përmetit me qendër në Përmet, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Përmetit.

21. Rrethi gjyqësor i Pogradecit me qendër në Pogradec, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Pogradecit.

22. Rrethi gjyqësor i Pukës me qendër në Pukë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Pukës.

23. Rrethi gjyqësor i Skraparit me qendër në Çorovodë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Skraparit.

24. Rrethi gjyqësor i Tepelenës me qendër në Tepelenë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tepelenës.

25. Rrethi gjyqësor i Tiranës me qendër në Tiranë , i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tiranës.

26. Rrethi gjyqësor i Tropojës me qendër në Bajram Curri, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tropojës.

27. Rrethi gjyqësor i Vlorës me qendër në Vlorë , i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Vlorës.

28. Rrethi gjyqësor i Bulqizës me qendër në Bulqizë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Bulqizës.

29. Rrethi gjyqësor i Kolonjës me qendër në Ersekë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kolonjës.

Neni 2

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani